

ANEKSI 1

TARIFAT PËR Oponencën Teknike Për Projektet e Veprave të Ndërtimit

1. Tarifa e oponencës për projektet e veprave të ndërtimit llogaritet si përqindje mbi tarifën e projektimit ku kostot e llogaritshme merren për tipologjinë e shërbimit. Tarifa e projektimit për llogaritjen e oponencës merret në vlerën sipas përcaktimeve në VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyerje dhe kolaudim”.
2. Fazat e për llogaritjen e tarifës merren nga faza I deri në faza V për të gjitha tipologjitë e shërbimeve, ndërsa për punimet e nëntokës dhe punimet e themeleve merren nga faza I deri tek faza III, sipas përcaktimeve në VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyerje dhe kolaudim”.
3. Tarifa e oponencës për ndërtime me kosto të llogaritshme nën 50 milion lekë janë në nivel rritës e shtuar me koeficientin ndryshimit, për ndërtesa me kosto të llogaritshme nga 50~300 milionë lekë tarifat ndërmjetëse merren me interpolim linear, ndërsa mbi 300 milionë lekë janë të pandryshueshme.
4. Tarifa për oponencë që zhvillohet në dy faza, oponencë për projektin e marrjes së lejes dhe oponencë për projektin e ndërtimit për fazën e dytë llogaritet me normat në përqindje të aplikueshme për fazën e shërbimit të përcaktuara në pikën 2 të aneksit 1 të këtij vendimi, duhet të reduktohen me 50%.
5. Në raste të ndryshme dhe për objekte të rëndësishme të veçantë, kur oponenti kryhen oponencën dhe të ndryshimeve të projektit gjatë zbatimit të punimeve, tarifat rritet me 20%.

Tarifa në përqindje për oponencën i referohen kostove të llogaritshme sipas tabelës.

Kostot e llogaritshme (milion lekë)	Tarifa (në %)
nën 50,00	7,0
100,00	6.5
150,00	6.0
200,00	5.5
250,00	5.0
300,00	4.5

AKT- MARRVESHJE

E mbajtur sot më datë ___/___/___, ndërmjet _____
Personit fizik/ juridik publik ose privat, vendas/ i huaj _____
Të përfaqësuar me autorizim nga Znj./Z. _____ më poshtë i quajtur
porositësi dhe institucioni që do të kryejë oponencën _____, të përfaqësuar
nga eprori i institucionit Znj./Z. _____ më poshtë i quajtur institucioni.

Palët në këtë marrëveshje bien dakord për sa vijon:

Neni 1

Objekti

Kryerja e oponences teknike, për projektin e ndërtimit të objektit _____, sipas
kërkesave të përcaktuara në VKM nr. _____ datë _____ “Për miratimin e rregullave për
projektet, që duhet t’i nënshtrohen oponencës teknike, si dhe procedurat që ndiqen”.

Neni 2

Afati

Afati dorëzimit të oponencës teknike pranë porositësit do të jetë brenda _____ ditë/ muaj nga
data e lidhjes së akt-marreveshje.

Neni 3

Vlefë

Vlera për realizimin e objektit të kësaj marrëveshje është _____ lekë.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

1. Porositësi kundrejt realizimit të akt-marrëveshjes kryen pagesat ndaj institucionit në numrin e llogarisë _____.
2. Pagesat për realizimin e objektit do të bëhen nga porositësi ndaj institucionit, duke u bazuar në tarifat e përcaktuara në VKM nr. _____ datë _____ “Për miratimin e rregullave për projektet, që duhet t’i nënshtrohen oponencës teknike, si dhe procedurat që ndiqen”.

3. Porositesi bën pagesën ndaj institucionit brenda _____ ditëve nga realizimi i objektit të kësaj marrëveshje.

4. Institucioni brenda afatit dhe kushteve të akt-marrëveshjes duhet të realizojë oponencën teknike për projektin e ndërtimit të objektit _____.

Neni 5

Sanksionet

Institucioni në rast se nuk realizon objektin brenda afatit të parashikuar në këtë akt-marreveshje duhet të paguajë saksionin 0.01 përqind të shumës totale, për çdo ditë vonesë.

Neni 6

Zgjidhja e mos marreveshjeve

1. Palët gjatë zbatimit të kushteve të akt-marrëveshjes komunikojnë me shkrim për zgjidhjen e problemeve që burojnë nga zbatimi i objektit.

2. Në rast se gjatë realizimit të akt-marrëveshjes lindin mosmarrëveshje palët i zgjidhin ato me mirëkuptim, në rast të kundërt i drejtohen Gjykatës së Shkallës së Parë për zgjidhje.

Neni 7

Kjo aktmarrëveshje hartohet në 3 kopje origjinale, me vullnetin e lirë dhe të plotë të palëve.

POROSITËSI

INSTITUCIONI

Znj./Z. _____

Znj./Z. _____